

Crna Gora
Opština Tuzi
JU KIC «Malesija» Tuzi
Broj/Nr.: 02-521/22
Tuzi/Tuz, 07.12.2022.god.

Mali i Zi
Komuna e Tuzit
IP QKI „Malësia“ Tuz

Na osnovu člana 23 Statuta JU KIC „Malesija“ Tuzi i shodno članu 19 Zakona o kulturi ("Službeni list Crne Gore", br. 049/08 od 15.08.2008, 016/11 od 22.03.2011, 040/11 od 08.08.2011, 038/12 od 19.07.2012) Savjet JU KIC „Malesija“ Tuzi, dana 07.12.2022 godine donio je:

ODLUKU


O usvajanju **Programa rada JU KIC za 2023 godinu, JU KIC „Malesija“ Tuzi.**

Në bazë të nenit 23 të Statutit të Institucionit publik QKI "Malesia" Tuz dhe në bazë të nenit 19 të Ligjit për kulturë ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. , 040/11 të datës 08.08.2011, 038/12 të datës 19 korrik 2012) Këshillit i Institucionit Publik QKI "Malesia" Tuz, me datën 07.12.2022 ka sjellë:

VENDIM

Për miratimin e **Programit të punës për vitin 2023 të Qendrës Kulturore-Informative "Malesia" Tuz.**

**PREDSJEDNIK SAVJETA
KRYETARI I KËSHILLIT**
Tomë Lucaj



Bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 18 e Vendimit për organizimin dhe mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr. 043/20 datë 18.12.2020) dhe në lidhje me nenin 15 të Vendimit për themelimin e Institucionit Publik Kulturo-Informativ të Malësisë (“Fleta Zyrtare e Republikës së Malit të Zi – dispozitat komunale”, Nr. 024/04 datë 28.07.2004, “Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale”, nr.028/11 datë 13.09.2011, 005/22 datë 03.02.2022), duke zgjidhur sipas kërkesës nr.12140, datë 08.12.2022, Sekretariati për Vetëqeverisjen Lokale jep:

PËLQIMIN

Duke vepruar sipas aktit të paraqitur nr. 12140 nga 08.12.2022. dhe në lidhje me aktin 01-526/22- datë 12.2022, me të cilin kërkoni nga ky organ i së drejtës publike pëlqimin për Programin e Punës.

Pas shqyrtimit të aktit në fjalë, ju njoftojmë se japim pëlqimin dhe mendimin pozitiv për Programin e Punës së Institucionit Publik QKI “Malesia” për vitin 2023.

Neni 5 paragrafi 1 pika 18 e Vendimit për organizimin dhe mënyrën e funksionimit të Administratës Lokale të Komunës së Tuzit parasheh që Sekretariati për Vetëqeverisje Lokale kryen punë që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen administrative dhe detyrat e ushtrimit të të drejtave të themeluesit në shërbimet publike në zonat nën juridiksionin e tij; dhënien e mendimeve dhe përgatitjen e pëlqimit për statutin, programin e punës dhe aktet për organizimin dhe sistemimin e brendshëm të atyre shërbimeve publike, mendimet për raportet e punës dhe propozimin e masave në lidhje me materialet e tyre informative dhe të tjera.

Neni 15 i Vendimit për themelimin e Institucionit Publik Qendrës Kulturore dhe Informative të Malësisë parashikon që themeluesi jep pëlqimin e tij për Programin e Punës së Institucionit Publik.

SEKRETARJA,

Marina Ujkaj

Dorëzuar:

- Kreut
- lëndes
- shërbimit të kryetarit
- a/a



IP QKI “Malësia” Tuz

PROGRAMI I PUNËS

për vitin 2023



Tuz, dhjetor 2022

1. HYRJE

Institucioni Publik QKI "Malësia" Tuz, themeluesi i të cilit është Komuna e Tuzit, kryen veprimtari me qëllim që të ruajmë dhe zhvillojmë programin teatral, muzikor, krijimtarinë pamore dhe letrare, filmit, duke u bazuar në Statutin e institucionit dhe ligjit për kulturë ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi" num. 049/08 nga 15. 08. 2008, 016/11 nga 22. 03. 2011, 040/11 nga 08. 08. 2011, 038/12 nga 19. 07. 2012), Vendimit për themelimin e IP QKI "Malësia" Tuz dhe i cili si prioritet të vetin e ka veçanërisht të kujdeset për afirmimin dhe veçoritë kulturore e gjuhësore të mjedisit, më saktë të Komunës së Tuzit.

Gjatë miratimit të Programeve të punës gjatë gjithë këtyre viteve, ideja me të cilën jemi udhëhequr është promovimi i krijimtarisë kulturore të krijuesëve nga territori i komunës sonë. Aktivitetet e Institucionit janë të parapara me program dygjuhësor, që do të thotë në gjuhën shqipe dhe zyrtare.

Qëllimi i miratimit të Programit të punës:

- Planifikimi i aktiviteteve programore në bazë të cilësisë dhe në përgjithësi fushëveprimi i Institucionit për vitin e ardhshëm;
- Planifikimi financiar për realizimin e aktiviteteve programore dhe aktiviteteve të tjera të domosdoshme nga fushëveprimi i punës së Institucionit në periudhën e ardhshme (1 janar – 31 dhjetor 2023).

Programin e punës për vitin 2023 e kemi bërë duke shfrytëzuar eksperiencat pozitive nga vitet e kaluara dhe në të njëjtën kohë duke filluar nga:

- mundësitë financiare,
- mundësitë hapësinore dhe teknike (objektet, hapësirat, stafi teknik),
- angazhimet zhvillimore.

1.1. Detyrat dhe punët

Fushëveprimi i Institucionit dhe kompetencat për kryerjen e punëve të planifikuara lindin nga vendimet për themelimin e Institucionit Publik, Qendra Kulturore – Informative "Malësia" num. 01 - 03/ 22 – 703 nga 24. 01. 2022 vjet, neni 19 i ligjit për kulturë ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi", num. 049/ 08 nga 15. 08. 2008, 016/ 11 nga 22. 03. 2011, 040/ 11 nga 08. 08. 2011, 038/ 12 nga 19. 07. 2012) të statutit dhe akteve të tjera të përgjithshme të Institucionit.

Veprimi i Institucionit tonë është i përcaktuar në përputhje me vendimin për themelimin dhe statutin, dhe për bazë ka ofrimin e shërbimeve në: muzikë, folklor, arsim, arte pamore, dramë dhe film, si dhe në veprimtari të tjera siç janë: dhënia me qera, organizim i takimeve, jubileve, promovime, prezentime dhe të tjera, përkatësisht veprimtari të cilat zakonisht kryhen me aktivitete kulturore – informative.

Me profilizim të programit dhe qasje kreative QKI "Malësia" Tuz edhe në vitin 2023, do të vazhdojë që nëpërmjet cilësisë programore të mirë të arrijë standarde të përgjithshme më të larta kulturore dhe estetike. Plani është i projektuar në bazë të elementeve dhe veprimtarisë së deritanishme të këtij Institucioni, duke respektuar vlerat dhe zakonet e mjedeisit tonë. Natyrisht aktivitetet programore janë të konceptuara si gërshetim i modernes dhe traditës, duke u kujdesur për specifikat gjuhësore dhe afirmim të multikulturalizmit, si një nga vlerat themelore të Malit të Zi.

Përmes veprimtarisë së shoqatave do të vazhdojmë me afirmim të potencialeve krijuese në sferën e artit amator në Tuz, i cili do të ndihmojë në ruajtje dhe zhvillim të Etnokulturës, si pjesë e trashëgimisë kulturore, e cila paraqet bazë të identitetit nacional dhe kulturor.

QKI "Malësia", ashtu si viteve të tjera do të jetë qendër për shpërndarjen e multikulturalizmit, me përmbajtje emancipuese. Duke u mbështetur në strategjinë gjenerale të përgjithshme të Komunës së Tuzit, do të vazhdojmë të bashkëpunjmë me institucione kulturore të vendit dhe rajoit. Gjatë gjithë këtyre viteve skenën teatrore e të muzikës të QKI- së, e formësuan dorëshkrime të ndryshme. Me këtë praktikë do të vazhdojmë edhe vitin e ardhshëm, kështu që publikut të Tuzit do t'i prezantohen artistë të shumtë të orientimeve estetike të ndryshme, me kompozime dhe vlera të ndryshme kulturore. E gjitha kjo, besojmë se, do të kontribuojë në krijimin e profilit kulturor të njohur nga Tuzi dhe QKI- në, "Malësia" ta pozicionojë si gjenerator qendror të të gjitha përmbajtjeve kualitative kulturore. Në programin e punës për vitin 2023, janë të përfshira aktivitete të ndryshme nga fusha e muzikës, folklorit, teatrit, arteve pamore dhe arsimit. Me këtë renditje është i konceptuar edhe programi i punës për vitin 2023.

2. AKTIVITETET PROGRAMORE

2.1. Programi muzikor

Aktivitetet e Programit Muzikor kontribuojnë më së shumti në afirmimin dhe fuqizimin e amatorizmit në Tuz. Gjatë këtyre shtatëmbëdhjetë vjetëve të punës është arritur një numër i konsiderueshëm i të ftuarve nga ansamblet më të shquara nga vendi dhe më gjerë.

Në vitin 2023 do të prezantohet para publikut krijimtaria muzikore vendase dhe e huaj e zhanreve të ndryshme muzikore.

Si zakonisht, ne do të mbështesim të gjitha shoqëritë kulturore dhe artistike që operojnë në zonën e Komunës së Tuzit. Në program planifikojmë edhe koncerte të muzikës klasike, si dhe shfaqje nga interpretues dhe grupe muzikore vendase. Pra, publikut tonë do t'i prezantohet një repertor i larmishëm muzikor, i cili do të përfshijë koncerte të muzikës klasike, muzikës popullore tradicionale dhe muzikës qytetare të vjetër. Përveç skenës sonë në Tuz, për ne është shumë e rëndësishme të promovojmë kulturën dhe traditën tonë edhe në vende të tjera të Malesisë, ndaj në periudhën e verës, në skenën e Trieshit, do të organizojmë një koncert të ansambllit folklorik "Besa". Prej këtij viti po planifikojmë një koncert që do ta realizojmë me profesorë, nxënës dhe nxënës të një shkolle muzikore në Malësi, në mënyrë që të kontribuojmë në afirmimin e artistëve të rinj në vendin tonë. Përveç kësaj, në skenën tonë do

të dëgjojnë tingujt e muzikës klasike bashkëkohore si dhe kompozimet e muzikës së filmit. Programi muzikor i Institucionit do të përfshijë koncerte të njohura të muzikës kamertare. Së fundmi në Malësi ekziston një trupë baleti, e cila prej disa vjetësh po arrin suksese në vendin tonë. Balerinat e vogla, tashmë kanë performuar disa herë në skenën tonë dhe me talentin e punën e tyre meritojnë të jenë pjesë e programit tonë dhe vetëm kështu do ta afirmojmë këtë segment të amatorizmit, i cili ka kohë që është shumë i ndjekur.

<i>r.n</i>	<i>Emertimi i ansamblit</i>	<i>Emertimi i ngjarjes</i>
1.	SHKA "Ramadan Sharkiq"	Koncert tradicional (15 dhejtor)
2.	SHKA „Besa“	Koncert në Koritë (sipas mundësive)
3.	SHKA „Koha“	Koncerti i nëntorit (28 nëntor)
4.	SHKA "Ded Gjon Luli"	Koncert (6 prilli)
5.	SHKA "Rapsha"	Koncert folklorik
6.	SHKA "Liria"	Koncert folklorik në skenën e hapur në Milesh (qershor/korrik)
7.	SHKA "Deçiq"	Koncert-folklorik
8.	SHM "Vasa Paviq"	Koncert i muzikës klasike
9.	Koncert Elina Duni	Jazz music – Muzikë xhez
10.	Trupa e baletit "Tip-Toe"	Koncert – balet
11.	Grupi "Mars"	Koncert- live
12.	Mbrëmje e muzikës së vjetër qytetare Sukrija Zuti Serhatlic	Koncert solist
13.	Teatri i Operas dhe Baletit	Koncert „Suonos Albanicus“

2.2. Programi teatral

Në veprimtarinë teatrale, përqipemi të zhvillojmë kulturën për të vizituar teatrin, përmes cilësisë së programeve dhe aktiviteteve të ofruara, që synojnë fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit.

Gjatë vitit, në repertorin e programit të dramës, planifikojmë të bashkëpunojmë me teatro profesionistë të vendit dhe rrethinës, si dhe të mbështesim trupa amatore. Këtë vit do të kemi disa aktorë nga Shqipëria (Tirana), Kosova (Prishtina), Bosnja e Hercegovina (Sarajevë), Kroacia (Zagreb), Maqedonia e Veriut (Shkupi), si dhe nga Mali i Zi (Podgorica). Ky program i pasur teatral do të jetë një hyrje për vitin e ardhshëm, vit në të cilin gjithashtu planifikojmë një Festival në fushën e teatrit. Repertori do të përfshijë pjesë shumë interesante për fëmijë. Gjatë gjithë këtyre viteve, në bashkëpunim me shkollat fillore, kemi ushqyer publikun e ri dhe shfaqjet për fëmijë kanë qenë gjithmonë jashtëzakonisht të ndjekura. Kur bëhet fjalë për skenën e mbrëmjes, programi i zhanrit të dramës është i larmishëm, ndaj këtë vit do të kemi situata drame dhe komedie. Gjithashtu edhe këtë vit planifikojmë prodhimin vetanëk të institucionit.

Skena teatrorë

r.n.	Emertimi i shfaqjes	Qyteti/ Shteti	Emeritimi i prodhuesit/produksioni	Zhanër
1.	„Natës poetike Migjeniane“	Pogradec	Grupimi për Artin	Dramë
2.	„Brekët“	Tiranë	Tirana Art	Komedi
3.	„Lahuta e Malësisë“	Prishtinë	Ekoling	Monodramë
4.	„Një fishkëllimë në errësirë“	Kumanovë	Teatri Shqiptar i Kumanovës	Dramë
5.	„Ja, Bosanac“	Sarajevë	UAKV Filter	Komedi
6.	„Lopata e artë“	Kroaci	Teatri Mergimtari	Monodramë

Shfaqje për fëmijë

r.n.	Emertimi i shfaqjes	Qyteti/ Shteti	Emeritimi i prodhuesit/produksioni	Mosha/ Zhanër
1.	„Borëbardha dhe shtatë xhuxhat“	Tiranë	„Teatri i kukullave“	5+
2.	„Ariel në shtëpinë e kukullave“	Tiranë	„Shoqata BoArt“	5+
3.	„Dy mijë milje nën det“	Podgoricë	„Teatri i qytetit të Podgoricës“	5+
4.	„Si është bërë e sjellshme princeshë Edina“	Plavë	Qendra për Kulturë Plavë	5+

2.3. FESTIVALI I TEATRIT SHQIPTAR

IP QIK "Malësia" Tuz, planifikon që në vitin 2023 të themelojë një manifestim teatral të quajtur "Festivali i Teatrit Shqip", i cili sipas mendimit tonë do të kontribuonte ndjeshëm në afirmimin e kulturës teatrale në nivel lokal dhe më gjerë. Aktiviteti i cili do të zgjaste katër ditë në nëntor, eventualisht dhjetor, do të mblidhte ansamble gjysmë-profesioniste dhe profesioniste nga vendi dhe rajoni me synimin për t'u bërë tradicional dhe për të zënë një vend të njohur në hartën e ngjarjeve teatrale në Mal të Zi. Besojmë se duke krijuar një manifestim teatral, Tuzi do të bëhej një vend i njohur për takime të krijuesve teatror, shkëmbim përvojash, idesh dhe bashkëpunime institucionale në të ardhmen. Krahas premierës me të cilën planifikojmë të paraqitemi para publikut tonë në vitin 2022 nën produksionin e QIK-së, me një trup teatror gjysmë-profesional, repertori i manifestimit do të përbëhej prej tri shfaqjeve të tjera nga rajoni. Në radhë të parë nga Shqipëria dhe Kosova për faktin se janë të realizuara në gjuhën shqipe. Jemi të bindur se vizita e teatrove të shquar me produksionet e tyre do të inkurajonte publikun tonë për teatrin. Ky argëtim i publikut dhe nxitja e dëshirës për krijimtarinë teatrorë, do të ndihmonte edhe në krijimin e skenës sonë të pavarur e cila do të shfaqte vazhdimisht pjesë teatrale me pjesëmarrjen e amatorëve dhe profesionistëve nga zona e Komunës së Tuzit dhe Malit të Zi. Veç kësaj, eventit do të shoqërohej me mbështetje mediatike dhe aktivitete të përshtatshme marketingu që do ta bënin këtë program të dukshëm dhe të njohur për publikun e gjerë. Në këtë mënyrë, promovimi publik i manifestimit do ta bënte Tuzin një nga qendrat e jetës teatrale në Mal të Zi gjatë kohës që do të zgjaste manifestimi. Në këtë mënyrë, Institucioni ynë, i cili ka kushte optimale teknike dhe hapësinore për prezantimin e njësive të tilla programore do të zgjeronte fushën e veprimtarisë së tij duke zbatuar një projekt ambicioz që do të realizohej për herë të parë në Komunën e Tuzit. Ngjarja e parë, në varësi të suksesit të saj, do të përfaqësonte edhe një hyrje në hapat dhe aktivitetet e mëtejshme të programit. Pas themelimit, e konsiderojmë të justifikuar që të bëhet tradicional dhe nëse është e mundur të shëndërrohet në një festival ku do të jepeshin çmime për interpretimet dhe krijimet më të mira të veprimtarisë skenike. Në krye të këtij eventit do ishte një juri ekspertësh nga vendi dhe rajoni, ku do të ishin emra të dalluar në fushën e teatrit, letërsisë dhe arteve. Gjithashtu, në të ardhmen manifestimi do të pasurohej me përmbajtje të tjera si panele dhe tryeza të rrumbullakta me tema të shumta si zhvillimi i veprimtarisë teatrorë, gjendja e nevojave kulturore apo bashkëpunimi teatror. Gjithashtu, repertori mund të zgjerohet për të përfshirë shfaqje nga vende të tjera të rajonit, në varësi të mundësive financiare dhe interesit të publikut. Festivali i ardhshëm mund të shoqërohet me shfaqje filmash, ekspozita fotografish, apo fokus në punën e artistëve të shquar të teatrit.

Duke qenë se është një manifestim që planifikojmë ta zhvillojmë si tradicional çdo vit në Komunën tonë, kohëzgjatja e festivalit të parë do të jetë 4 ditë, d.m.th. Festivali hapet me shfaqjen e QKI-së "Malësia" (natën e parë) dhe 3 netët e tjera do të jenë shfaqje teatrale nga zona përreth. Duke qenë se bëhet fjalë për vazhdimësi, buxheti për këtë festival përfshin kostot e mëposhtme: **shfaqje, transport, ushqimi, akomodimi, si dhe organizatat (plani mediatik, i logjistikës teknike, etj.)** për një kohëzgjatje prej 4 ditësh.

2.4. Prodhimi vetenak i IP QKI "Malësia" Tuz

Bazuar mbi eksperiencën e mëhershme të asaj që kemi parë në Malësi, kur bëhet fjalë për aktrim, stafi i QKI "Malësia" Tuz, është i mendimit se ne mund të arrijmë të krijojmë një bërthamë e cila do të jetë embrion i asaj që është pikësynimi i të ardhmes, e që është hapja e teatrit. Prodhimi ynë vjetor, do të jetë një garant i së ardhmes së mbarë.

Duke pasur parasysh specifikat e veçanta dialektore që ne kemi, në të gjithë hapësirat shqipfolëse, jemi të mendimit se duhet ndjekur një politikë teatrore e cila do të mund të kamuflon pengesat dhe barrierat që ne kemi, pasi që dihet se teatri është për të edukuar gjuhësisht në rrall të parë, që do të thotë se duhet të na kuptojnë gjithandej ku flitet gjuha shqipe.

Komedia është ajo e cila është pikësynimi ynë i së ardhmes, dhe një gërshetim shumë i kujdesshëm në mes plejadës së aktorëve të vjetër dhe të rinj. Duke menduar se do të jepë rezultatin e shumëkërkuar, që në të ardhmën të bëhen edhe prodhime më të mëdhaja dhe gjigante nga ana e institucionit.

Ajo e cila mund të merret për bazë dhe si kampion është se gjithandej nëpër vende të ndryshme të rajonit dhe më gjerë, ku sot kemi teatro të forta, është filluar në mënyrë amatore, por që sot ato teatro gëzojnë reputacion të fortë profesional.

2.5. Programi i arteve pamore

Në fushën e artit organizohen ekspozita personale, kolektive me tematikë retrospektive. Qëllimi ynë është të inkurajojmë afirmimin e artistëve të rinj dhe prezentimin e tyre në publik.

Gjithashtu, po planifikojmë disa ekspozita që do të kenë karakter edukativ, bartës të cilave janë OJQ-të, dhe shkollat nga zona e Komunës së Tuzit. Përveç artistëve tanë, do të prezantojmë edhe artistë nga rajoni.

Ne do të mbështesim në mënyrë logjistike dhe organizative aktivitetet e Sekretariatit për Vetëqeverisje Lokale të Komunës së Tuzit (Kolonia e Arteve Pamore "Gjelosh Gjokaj" etj).

r.n.	Autor	Lloji i ekspozitës
1.	Majlinda Kelmendi (Prishtinë)	"Ekspozitë personale"
2.	Mir Juka (Shkodër)	„Ekspozitë kolektive“
3.	Ekspozita e muzeut natyror	„Muzeu natyror i Malit të Zi“
4.	Prof. Ilir Martini (Tiranë)	"Ekspozitë personale"
5.	SHF „Mahmut Lekiq“	"Ekspozita kolektive e artit"
6.	Leo Gjokaj	"Ekspozitë personale"
7.	Galeria e Artit Tiranë-Ormira Lulani	„Ekspozitë kolektive“

2.6. Programi arsimor - letrar

Janë planifikuar mbrëmje letrare, forume dhe tryeza të rrumbullakta, ku do të promovohen arritjet aktuale të krijuesëve nga komuna e Tuzit, nga fusha e letërsisë, historisë, politikës dhe sociologjisë. Çdo vit kemi festuar "Ditën Botërore të Librit" si dhe afirmimin e shkrimtarëve nga Komuna e Tuzit.

Në kuadër të këtij programi do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me bibliotekat dhe institucionet arsimore. Sipas statutit të Institucionit, ne po planifikojmë edhe hapjen e bibliotekës sonë. Këtë vit për herë të parë organizuam një konkurs poetik të quajtur "Poezia na bashkon" për nder të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit dhe këtë aktivitet do ta realizojmë çdo vit. Dhe për vitin e ardhshëm kemi në plan ta zgjerojmë idenë dhe vetë aktivitetin.

Si mbështetje logjistike për Sekretariatit për Vetëqeverisje Lokale të Komunës së Tuzit, QKI "Malësia" do të planifikojë mbështetjen për organizimin e Panairit ekzistues të Librit në Tuz.

Promovimet dhe takimet letrare:

r.n.	Autor/shkrimtar	Emertimi i librit/programit
1.	„Shqiptarët në MZ gjatë tri dekadave të fundit“	OJQ Art Club
2.	Dita e poezis „7 marsi“	„Poezia na bashkon“
3.	Stefan Çapaliku	„Mbrëmje me autorin“
4.	Mehmet Kraja	„Bisedë me Kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës“
5.	Anton Vukpalaj	„Mbrëmje me autorin“

2.7. Programi kinematografik

QKI "Malësia", me disa investime të vogla të nevojshme, do t'i arrijë kushtet teknike për organizimin e një programi kinematografik, andaj synojmë që këtë segment të kulturës ta iniciojmë në bashkëpunim me institucionet tjera që merren me aktivitete kinematografike. Prurjet aktuale dhe të vazhdueshme në tregun kinematografik, do të na sugjerojnë që në të ardhmen të arrijmë bashkëpunim në nivelin rajonal. Dhe krijimtaritë sidomos shqiptare të cilat kanë arritur majat e kinematografisë botërore të shfaqen edhe për publikun e gjerë të Malësisë.

r.n	Titulli i filmit	Autori	Zhanri
	„Na ishte njëherë Shqipëria“	Stefan Çapaliku	Film dokumentar

Buxheti total i aktiviteteve programore

Programi muzikor	14,500
Programi dramatik	11.600
Festivali i Teatrit	9 300
Prodhimi vetenak	10 000
Artet pamore	5.700
Programi arsimor letrar dhe filmik	4200
Totali	55.300

3. BASHKËPUNIMI ME ORGANE, INSTITUCIONE DHE ORGANIZATA

Institucioni ynë përmes aktiviteteve të veta programore do të tentojë që ta ngris në nivel edhe më të lartë bashkëpunimin aktual me departamentin e Sekretariatit për vetëqeverisjen lokale, organet administrative, institucionet teatrore nga vendi dhe rajoni, institucionet publike nga fusha e kulturës dhe arsimit, OJQ- të, si dhe mjetet e informimit,. Do të synojmë që përmes ardhjes së mysafirëve nga vendet e ndryshme, ofertat tona t'i bëjmë e të jenë edhe më kualitative, më të pasura dhe të gjithëpranuara.

QKI "Malësia", shprehë interesim të veçantë për të vazhduar me praktikën e bazuar për organizim, pjesëmarrje dhe realizim të manifestimeve me rëndësi të posaçme për Komunën e Tuzit. Jemi të mendimit se pjesëmarrja e QKI-së, "Malësia" në evente të tilla do të jepte efektet e veta pozitive. Sa më sipër është në favor të faktit se QKI, është bërë qendër dhe mbartës i veprimeve kulturore, në Komunën e Tuzit, që ishte një nga qëllimet primare edhe kur u themelua.

4. NUMRI DHE STRUKTURA KUALIFIKUESE E TË PUNËSUARËVE

Organizimi aktual i veprimtarisë së Institucionit është i përcaktuar me rregullore për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës. Aktualisht janë të punësuar 17 veta. Struktura kualifikuese e të punësuarëve është si më poshtë:

Gjashtë (6) të punësuar me arsimim të lartë universitar

Dhjetë (10) të punësuar me arsimim të mesëm dhe,

Një (1) i punësuar me shkollë fillore

5.MJETET BUXHETORE – IP QKI “MALËSIA” TUZ

Palni financiar për vitin 2023

Kl.ekon.	Kl.ekon.	përshkrimi	Buxheti 2022	Buxheti 2023	%
		1	2	3	4
7		TË ARDHURAT	205 000,00	310 000,00	151,22
		Transfertë e Komunës Tuz	205 000,00	290 000,00	141,46
		Të ardhurat e veta	0,00	0,00	
		Donacionet	0,00	20 000,00	
4		SHPENZIMET (TË DALAT)	205 000,00	310 000,00	151,22
		Shpenzimet e vazhdueshme	183 600,00	234 700,00	127,83
411		Bruto të ardhurat dhe kontributet e punëdhënësit	149 885,44	188 700,00	125,90
412		Të ardhurat tjera personale	5 775,00	6 300,00	109,09
	4131	Materiali administrativ	1 346,95	3 200,00	237,57
	4134	Shpenzimet për energji-rrymë	4 265,72	6 000,00	140,66
	4135	Shpenzimet për karburante	5 270,00	8 200,00	155,60
413		Shpenzimet për material	10 882,67	17 400,00	159,89
	4141	Udhëtimet zyrtare	200,00	1000,00	500,00
	4142	Përfaqësimi	200,00	1000,00	500,00
	4143	Shërbimet e komunikimit	481,82	660,00	136,98
	4144	Shërbimet bankare	231,82	400,00	172,55
	4149	Shërbimet të tjera	6873,25	5640,00	82,21
414		Shpenzimet për shërbime	8 028,71	8 700,00	108,36
	4152	Mirëmbajtja aktuale e godinës	250,00	314,40	125,78
	4153	Mirëmbajtja e vazhdueshme e pajisjeve	250,00	500,00	200,00
415		Shpenzimet për mirëmbajtjet të vazhdueshme	500,00	814,40	162,89
	4191	SHPENZIMET NË BAZË TË PAGESËS SË KONTRATAVE PËR PUNË	3000,00	10 000,00	333,33

	4193	VENDOSJA DHE MIRËMBAJTJA E SOFTWERËVE	2 200,00	2 400,00	109,09
	4194	SIGURACIONI	300,00	385,60	128,54
	4196	KOMPENSIMET KOMUNALE	3028,18	0,00	350,00
419		SHPENZIME TË TJERA	8 528,18	12 785,60	149,92
431		Tranferrat drejt institucioneve, individëve, sektorit publik dhe joqeveritarë	15 800,00	55 300,00	350,00
441		Shpenzimet kapitale	5 600,00	20 000,00	357,14

4.

KOMENT: Buxheti i IP QKI "Malësia" Tuz është planifikuar në vlerë absolute prej 310,000.00 euro për vitin 2023, që është 151.22% më shumë krahasuar me vitin 2022. (shuma absolute e buxhetit ishte 205,000.00 euro).

Të hyrat nga buxheti i komunës (të hyrat e dedikuara janë 290.000.00 euro, ose 93.55%), ndërsa donacionet janë 20.000.00 euro ose 6.45%, në raport me buxhetin e përgjithshëm.

Shpenzimet e vazhdueshme përbëjnë 75,71% të buxhetit total, ose janë 127,83% më të larta se në vitin 2022. Struktura e shpenzimeve korrente e shprehur në përqindje është si më poshtë: Paga bruto 80,40%, Shpenzime të tjera personale 2,68%, Shpenzime për materiale 7,41%, Shpenzime për shërbime 3,71%, Shpenzime për mirëmbajtje korrente 0,35% dhe Shpenzime të tjera 5,45%. Duhet theksuar se të ardhurat bruto të planifikuara për vitin 2023 marrin pjesë me 60.87% në buxhetin total dhe janë më të larta në vitin 2022, me 125.90%. Numri aktual i të punësuarve është 17, ndërsa planifikojmë të punësojmë edhe 2 përmbaues të tjerë.

Fondet e parashikuara për aktivitetet programore arrijnë në 55,300,00 euro dhe janë më të larta se në vitin 2022 (15,800,00) me 350,00%. Pjesëmarrja e tyre në buxhetin total është 17,84%. Struktura është si vijon: mjetet e planifikuara për realizimin e aktiviteteve programore arrijnë në 36.000.00 euro, për mbajtjen e festivalit të dramës 9.300.00 euro dhe për produksion dramatik vetanë 10.000.00 euro.

Planifikimi i buxhetit kapital arrin në 20,000.00 euro dhe është më i lartë se në vitin 2022, me 357.14%. Burimet e financimit janë donacionet, ndonëse presim të marrim mjete edhe përmes aplikimeve, përmes partnerëve, para së gjithash Shërbimit për Bashkëpunim Ndërkombëtar të Komunës së Tuzit, me fondet e BE-së dhe disa ambasada.

DREJTOR,
Vasel Berishaj

Vasel Berishaj